

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Kush po e drejton Bashkinë?', Teliti: Këshilltarët socialistë duan Veliajn në Këshill, jo qytetarët e Tiranës
ADRESA	https://piranjat.al/politike/kush-po-e-drejton-bashkine-teliti-keshilltaret-socialiste-duan-veliajn--i106639
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 16:17:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 16:03:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d56cbd41f0e2a58362e05c046e498d0962c730c54b04e259cd7aa602d6a7c23a
TEKSTI	12c622655fa974750ac324b0cd8ca03946aec18e761fd76a7ce119698e133919
PAMJA	8c70dd5ce4717409b33a373f67672f0f92bb6fb85eae2d4a1d7f078561b6458b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	951104e163b5238fce808321b98d642e7b117833eea916a227fedc1153709bf9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4faa6bac1fdb621d5bb536e84f6e17d5297f7948d21ccae873a60f4b83f7089c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/951104e163b5238fce808321b98d642e7b117833eea916a227fedc1153709bf9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

Bundestagut:
Korrupsioni,

deputetja
na Zhupa,
zhvilloi një
takim me

31-vjeçar
në Tiranë

armatosur
me një
pistolet&eu...

dorëheqjen
e Ramës

kunder
qeverisë,
duke
deklaruar se

Kama nga
Brukseli:

Reflektuam
kryeministrit
Edi Rama,
ndërsa nga

motoçikleta,
transportohet

ne fshat
Shalës,
Cërrik:
Stavri

POLITIKE

'Kush po e drejton Bashkinë?', Teliti: Këshilltarët socialistë duan Veliajn në Këshill, jo qytetarët e Tiranës

Piranjat Përditësimi i fundit 29 Shtator 2026, 18:03



Në një intervistë në edicionin e pasdites në Syri TV, Nënkrjetari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, Dorian Teliti, denoncoi përpjekjet e këshilltarëve socialistë për të përdorur mbledhjen e Këshillit Bashkiak për rikthimin e Erion Veliajt në skenën politike.

Teliti tha se në vend që të dëgjohen qytetarët për ndryshimet e reformës territoriale-administrative, mazhoranca kërkon të dëgjojë vetëm Veliajn, duke kërkuar që banorët e Kombinatis, Qendrës, Kinostudios, Vaqarrit, Kasharit, Pezës, Ndroqit dhe Farkës të pyeten drejtpërdrejt për problematikat dhe nevojat e tyre.

Teliti kritikoi gjithashtu vonesën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe miratimin me vonesë të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë.

Ai ngriti pikëpyetje mbi funksionimin e Bashkisë së Tiranës dhe se kush po firmos aktualisht aktet dhe kontratat e institucionit, ndërsa Erion Veliaj ndodhet në paraburgim.

Teliti u shpreh se Veliaj duhet të kishte bërë një akt delegimi të një prej nënkryetarëve për të garantuar vijimin e punës së bashkisë, ndërsa akuzoi mazhorancën se po e mban institucionin të bllokuar dhe se nuk po i jep përparësi interesit të qytetarëve të Tiranës.

Pjesë nga intervista:

Të siguroj që Tirana është më mirë pa Erion Veliajn në zyrë, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Kur vinte në fillimet e këtij këshilli, kur vinte në Këshillin Bashkiak, bënte atë retorikën e shpifur, shpifëse në pjesën dërrmuese të rasteve, duke sjatur gjëra të paqena, pastaj si një frikak vraponte të hipte në zyrë apo për t'u larguar nga ambientet e bashkisë.

Si gjithmonë, ashtu siç është përdorur që Erion Veliaj është në paraburgim, këshilltarët e majtë janë munduar ta nxjerrin në ajrim Erion Veliajn, për ta sjellë dy-tre orë këtu në Tiranë, që ai të bëjë atë retorikën e vet politike, përsëri shpifëse, denigruese dhe absolutisht jo në interes të qytetarëve.

Çfarë do të diskutojë sot Këshilli? Do të diskutojë një propozim të ardhur nga Kuvendi i Shqipërisë, nga një grup deputetësh të mazhorancës socialiste, për sa i përket ndryshimeve të reformës territoriale-administrative.

Çfarë na duhet ne mendimi i Erion Veliajt? Pse na duhet mendimi i qytetarëve të Tiranës? Dhe këtë kërkuam sot në Këshill, këtë kërkoja edhe në emër të opozitës sot në Këshill.

Të shkojmë te qytetarët, t'i pyesim çfarë duan ata, të pyes qytetarët e Kombinatis, qytetarët e qendrës, Kinostudios, Vaqarrit, Kasharit, të Pezës, Ndroqit, po edhe të Farkës, t'i pyesim çfarë problematikash kanë ata, çfarë halesh kanë ata, t'i pyes se çfarë duhet bërë dhe riformatur Tirana.

Por jo, për këshilltarët socialistë nuk duhet pyetur shqiptarët e Tiranës, por duhet pyetur vetëm Erion Veliaj. Këtë e bëjnë si instrument që ai të dalë dy-tre orë, sepse nuk e konsiderojnë të qenurit këshilltarë si një detyrim për t'u shërbyer qytetarëve, por e shohin të qenurit si detyrim për t'i shërbyer kryetarit, i cili, e dimë tashmë, ka akuza të rreshtuara njëra pas tjetrës, mbi 11 akuza, njëra më e rëndë se tjetra, të gjitha lidhen me shkelje të hapura të interesit publik dhe ekonomik të qytetarëve të Tiranës.

Ne sot kërkuam se pse i kemi dy muaj e gjysmë pa u mbledhur në Këshillin Bashkiak të Tiranës. E dini që sot Këshilli Bashkiak do të miratojë ndihmën ekonomike të muajit korrik, pra, pasi bënë plazh mirë e mirë këshilltarët socialistë, pasi u enjtën drekave dhe darkave në plazhet e Shqipërisë dhe jashtë Shqipërisë, i harruan që kjo Tiranë ka mbi një mijë familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, kanë nevojë për ato qindarka që i jep buxheti i qytetarëve të Tiranës për të mbajtur frymën gjallë.

Nuk u zhvillua mbledhje në muajin gusht se kishin pushime, zotërinj dhe zonja, mirë, në gusht, por as në ditët e para të shtatorit nuk u mbledh Këshilli Bashkiak, me justifikim se donin të prisnin datën 16 shtator, me shpresën e madhe që lideri i tyre, ai i tyre, do të lirohej dhe t'u vinte më në fund dhe të shikonin ëndrra me sy hapur në Këshillin Bashkiak të Tiranës.

Mirë, kaloi data 16, por pritëm deri në fund të muajit shtator, pra ditën e sotme, për të miratuar jo ndihmën ekonomike të shtatorit, jo të gushtit, por ndihmën ekonomike të korrikut. Kjo është një situatë skandaloze.

Dhe, për më tepër, ngritëm sot zërin fuqimisht edhe për të pyetur, për të qartësuar jo qytetarët, por edhe ne, se kush po firmos sot Bashkia e Tiranës, kush është ai sot që firmos marrjen e angazhimeve në Bashkinë e Tiranës, kush është ai që firmos sot kontratat e Tiranës. Është ende e paqartë. Zyrtarisht është Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë së Tiranës, por ka mundësi që ai ta ushtrorë, ende nuk ka bërë delegim.

Doli vendimi i Gjykatës së Lartë që ai nuk do të lirohet nga qelia dhe ka vazhduar dhe këto dy javë, jo ta çlirojë Tiranën duke e bërë aktin sublim të dorëheqjes, të bënte aktin tjetër të delegimit që një prej nënkryetarëve, për të vazhduar atë mbarrëvajtje minimale të punëve të Tiranës, por nga Durrësi, zotëria vazhdon prej një viti e gjysmë që mban peng Tiranën.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 29 Shtator17:28

[Ambasada e SHBA: Ambasadori Wendt merr detyrën në Shqipëri. Një kapitull i ri në marrëdhëniet mes dy vendeve](#)

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë ka njoftuar zyrtarisht marrjen e detyrës nga ambasadori i ri amerikan në Shqipëri, Eric...

POLITIKE 29 Shtator17:02

[Dua Lipa mbështeti protestën e shqiptarëve, Rama: E dua shumë, por ajo është këngëtare, jo Papa](#)

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar një takim në Bruksel në lidhje me turizmin, ku u shpreh se vendi ynë ka si qëllim arritjen e majave ...

POLITIKE 29 Shtator16:44

[Vendimi për Avokatin e Popullit, Bardhi: Mashtrimi publik i Gjykatës Kushtetuese për akte dhe fakte që janë të njohura botërisht](#)

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila rrëzoi kërkesën e ...

POLITIKE 29 Shtator16:33

[Denoncimi i Piranjave/ Luçiano Boçi: Taulant Balla kujton se ligji është si doktoratura e tij e arnuar me plagjiatura copa-copa nga të tjerët](#)

Piranjat në emisionin e javës së kaluar vërtetuan se diploma e mbrojtur në vitin 2015 në Universitetin Aleksandër Joa...

POLITIKE 29 Shtator16:18

[Dënimet e ish-drejtimesve të UÇK-së, Berisha nga Strasburgu: Apeli t'i shqyrtojë objektivist](#)

Sali Berisha foli në Bruksel për zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon, duke u ndalur te zgjedhjet e përsëritura, procesi i zgje...

POLITIKE 29 Shtator16:09

[Skandali i SHISH/ Strazimiri: SPAK i ka provat edhe për Edi Ramën dhe nuk vepron](#)

Deputeti i Partisë Demokratike Gent Starzimir në një intervistë deputeti demokrat tha se SPAK i ka provat për Edi Ramën por nuk ve...

POLITIKE 29 Shtator16:05

[Skandalet e qeverisë/ Ina Zhupa me delegacionin e Bundestagut: Korrupsioni, pengesë për integrimin në BE](#)

Kryetarja e Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën, deputetja Ina Zhupa, zhvilloi një takim me delegacionin e Bundestagut gjerman, ...

POLITIKE 29 Shtator15:48

[Tenderi i antenave të RTSH, hije skandali mbi KPP](#)

Kur kanë kaluar mbi dy muaj që Komisioni i Porkurimit Publik mban peng dosjen e tenderit për mirmëmbajtjen e antenave të Radiotelivizion...

POLITIKE 29 Shtator14:57

[Prej 5 muajsh shqiptarët i kërkojnë dorëheqjen, Rama nga Brukseli: Reflektuam, krijuam 'pasqyrën inteligjente'!](#)

Prej pesë muajsh protestat vijojnë me kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama, ndërsa nga Brukseli kreu i qeverisë&...

POLITIKE 29 Shtator14:20

[PD kërkesë për informacion zyrtar Kryeministrit dhe Presidentit për çështjen e SHISH](#)

Partia Demokratike i ka dërguar këtë të martë një kërkesë zyrtare për informacion Kryeministrit Edi Rama dhe Pres...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 28 Shtator

[VIDEO tronditëse/ Oficeri i policisë në pension...](#)

Ali Sekeroğlu kishte bërë thirrje për pjesëmarrje në një demonstratë kundër pensioneve të pamjaftueshme, përme...

BOTA 28 Shtator

[Krimi horror/ Pedagogia 'Satana' copëtoi trupin...](#)

Është Nicole Formichetti, 46 vjeçe, pedagogia që jetonte në apartamentin në rrugën "Tommaso Gulli" në Tori...

BOTA 29 Shtator

[Lidershipi i Inteligjencës Artificiale në Shtëp...](#)

Disa nga emrat më të fuqishëm në industrinë globale të inteligjencës artificiale po kalojnë këtë të mar...

Piranjat News INVESTIGIME 29 Shtator11:57

["2200 euro për person, kesh çdo ditë"/ Zbulohet skema si grupet kriminale rekrutojnë shoferët për transportin e emigrantëve ilegalë](#)

Një rrjet i organizuar që vepron përtej kufijve dhe që dyshohet se përfiton shuma të konsiderueshme nga trafikimi i emigrant&eum...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.